

DEKLARATË PËR SHTYP
PËR MIRATIMIN E REZOLUTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
DHE FORCIMIN E DEMOKRACISË NË SHQIPËRI



Tiranë, 23 dhjetor 2024

Më 18 dhjetor 2024, u mbajt forumi “Të drejta të shkelura”, një iniciativë e gjërë e 21 organizatash, sindikatash dhe koalicione të shoqërisë civile, të angazhuara gjerësisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, ku miratuan rezolutën “për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri.” Nëpërmjet kësaj rezolute evidentohen shkeljet alarmante e të drejtave themelore dhe lirive themelore duke theksuar rrezikun e gërryerjes së demokracisë në Shqipëri. Kjo rezolutë u adresohet institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, agjencive mbikëqyrëse, dhe mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me një apel të qartë për ndërhyrje dhe angazhim të menjëhershëm për të ndaluar këtë proces të rrezikshëm.

Në kuadër të kësaj rezolute, organizatat nënshkruese kërkojnë me forcë që të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm për të parandaluar thellimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat janë bërë të dukshme në çdo aspekt të jetës shoqërore, politike dhe ekonomike në Shqipëri. Liria e shprehjes, pavarësia e medias, dhe garantimi i të drejtave sociale dhe politike të qytetarëve janë të rrezikuara në mënyrë serioze nga abuzimet dhe keqpërdorimet e institucioneve shtetërore dhe nga heshtja e padrejtë e aktorëve politikë që kontribuojnë në krijimin e një klime të pasigurt dhe në kufijtë e cënimit të garancive kushtetuese për çdo qytetar shqiptar.

Në këtë kuadër:

1. Dënojmë shkeljet e vazhdueshme të raportuara të të drejtave të njeriut dhe standardeve demokratike në Shqipëri, përfshirë kërcënimet ndaj lirisë së shprehjes, manipulimet zgjedhore dhe gjendjen dramatike ne burgjet e vendit, 62 % e të burgosurve janë ne paraburgim, mungesën e transparencës në qeverisje.
2. Ritheksojmë se respektimi dhe garantimi i të drejtave themelore janë parakusht për një demokraci funksionale dhe për përmbushjen e aspiratave të popullit shqiptar për integrim European, partneritet atlantik, dhe prosperitet socio-ekonomik.

3. Kujtojmë se garantimi i të drejtave për çdo qytetar, përfshi gjatë proceseve hetimore, penale apo gjyqësore, është një parakusht për të evituar rrëshqitjen drejt një regjimi policor ku kufizimi i dhunshëm i lirive mbizotëron përkundrejt zbatimit të një procesi të drejtë gjyqësor;

4. Theksojmë nevojën për të adresuar këto sfida përmes një angazhimi kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë aktorët politikë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Ndaj, ne, organizatat dhe sindikatat nënshkruese, e shohim këtë moment si një thirrje të pandalshme për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi. Shkeljet e këtyre të drejtave janë shkelje të thella të dinjitetit të njeriut dhe kërcënim serioz për shoqërinë shqiptare. Rënia e institucioneve demokratike dhe shkelja e të drejtave të njeriut nuk janë vetëm një problem për ata që janë të prekur drejtpërdrejt, por një kërcënim për të gjithë shoqërinë.

Duke iu drejtuar Qeverisë Shqiptare, i kërkojmë

- **respektimin me rigorizitet e të drejtave të qytetarëve** në veçanti ato në lidhje me pronën private dhe lirinë e lëvizjes;
- garantimin e lirisë së shprehjes për qytetarët, mediat dhe përfaqësuesit politikë;
- për një proces zgjedhor vërtetë të lirë e të drejtë, përfshirë votimin e diasporës pa ndikim të presionit, burimeve shtetëore apo cdo forme që cënon këtë të drejtë kushtetuese;
- të krijojë një klimë të favorshme të ndarjes së pushteteve, të ndalohet instrumentatizimi apo politizimi i sistemit të drejtësisë
- Krijimin e një kulture dialogu të vërtetë dhe gjithëpërfshirëse për të ndalur shpopullimin, shkatërrimin e arsimit, shëndetësisë, pensionet, minimumin jetik e pronën.
- **Të mundësojë krijimin e një qeverie teknike sipas modelit të Maqedonisë së Veriut**, për të menaxhuar procesin zgjedhor dhe për të rikthyer besimin e qytetarëve në integritetin e zgjedhjeve.

Ndaj Komunitetit Ndërkombëtar i drejtohet duke i kërkuar:

- Monitorimin të zhvillimeve në Shqipëri për të rikthyer stnadartet demokratike e mbrotjen e drejtave të njeriut duke marrë në konsideratë rezolutat e fundit miratuara nga CDI, EPP dhe IDU
- Të vendosë presion ndaj qeverisë shqiptare për të ndalur shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të siguruar zbatimin e reformave që forcojnë demokracinë dhe sundimin e ligjit.
- Të ndërmjetësojë negociatat për krijimin e një qeverie teknike në shembullin e Maqedonisë së Veriut, që do të mundësojë një garë zgjedhore të lirë dhe të ndershme.

Ndaj Aktorëve të shoqërisë civile dhe opozitës politike Shqiptare, i kërkohet ti bashkohen nën një mision të përbashkët në mbrojtjen e të drejtave themelore, të vlerave universale dhe parimeve të Lirisë dhe të Drejtat Individuale; Shteti i së Drejtës; Fuqizimit të Qytetarit; Tregu të Lirë; Fuqizimit të Prodhimit Vendas; Një arsimit më cilësor; shkencor e patriotik; Një shëndetësi më dinjitoze; Mbrojtja e shtresës më vulnerabel të shoqërisë, e në veçanti pensionistëve; Mbrojtjen e

Trashëgimisë Kulturore e Historike; Mbrojtjen e Pronës Private; Dekomunistizimi dhe Drejtësi tranzicionale; Decentralizimi i balancuar i pushtetit dhe territorit; Ruatje e Mjedisit; Integrimi European; Mbrojtja e Shqiptarëve dhe Vlerave Kombëtare; Dinjiteti dhe Jeta Njerëzore; si dhe Rindërtimi i Shoqërisë.

Në përfunim, kërkojmë një bashkëpunim të fuqishëm dhe të pandërprerë mes aktorëve të shoqërisë civile, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, për të siguruar që të drejtat e njeriut të mbrohen dhe të zhvillohen, dhe për të parandaluar çdo lloj rreziku që mund të dëmtojë të ardhmen e demokracisë dhe stabilitetit në Shqipëri.